



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtina, më 25 janar 2013
Nr. ref.: RK373/13

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin Nr. KI82/12

Parashtruesi

Milorad Rajović

Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe të ligjshmërisë së zbatimit të Rregullores së UNMIK-it, Nr. 2000/4, dhe të Ligjit të Republikës së Kosovës, Nr. 2008/03 – L033

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Ivan Čukalović, Zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Kadri Kryeziu, gjyqtar, dhe
Arta Rama-Hajrizi, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtruesi i kërkesës është z. Milorad Rajović, pronar i N. P. “Udarnik Komerc” në Mitrovicë, të cilin e përfaqëson avokati Avni Q. Vula nga Prishtina (në tekstin e mëtejme: Parashtruesi).

Vendimi i kontestuar

2. Kontestohet kushtetutshmëria e zbatimit të Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 2000/4, “për statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe personelit të tij” (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2000/4), si dhe Ligji Nr. 2008/03 – L033 “për statusin, imunitetin dhe privilegjet e misionëve diplomatike, konsullore dhe personelin në Kosovë dhe praninë ndërkombëtare ushtarake si dhe personelin e saj” (në tekstin e mëtejme: Ligji Nr. 2008/03 – L033)

Objekti i çështjes

3. Parashtruesi i kërkesës e konteston mënyrën në të cilën Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë (në tekstin e mëtejme: OSBE) interpreton dhe zbaton Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000/4 si dhe Ligjin Nr. 2008/03 – L033. Ai pretendon se ato ligje kanë shkelur të drejtat e tij pronësore, të garantuara me nenin 46 [Mbrojtja e Pronës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, si dhe të drejtat dhe liritë e parapara me nenin 1 (Mbrojtja e Pronës) të Protokollit 1 të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (në tekstin e mëtejme: KEDNJ).

Baza juridike

4. Kërkesa është bazuar në nenin 113.7 dhe në nenin 21.4 të Kushtetutës; në nenin 20, në nenin 22.7 dhe në nenin 22.8 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, Nr. 03/L-121, të 15 janarit 2009 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 56, paragrafi 2, të Rregullores së punës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja).

Procedura në Gjykatë

5. Më 7 shtator 2012, parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë në Gjykatën Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Me Vendimin e Kryetarit (Nr. GJR. KI82/12, të 5 tetorit 2012), gjyqtari Robert Carolan është caktuar Gjyqtar raportues. Të njëjtën ditë, me vendimin e Kryetarit (Nr. KSH. KI82/12) është caktuar Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajziri.
7. Më 25 janar 2013, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarit Robert Carolan, Kolegji shqyrtues, i përbërë nga gjyqtarët: Altay Suroy (kryesues), Kadri Kryeziu dhe Arta Rama-Hajrizi, i paraqiti Gjykatës, në përbërje të plotë, rekomandimin për papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

8. Z. Milorad Rajović, pronar i N.P. “Udarnik Komerc”, tash me seli në Mitrovicë, pretendon se është pronar i pakontestueshëm i lokalit afarist, me një sipërfaqe të përgjithshme 1.078 m², i cili gjendet në Pejë, në adresën “Ndërtesa për banim Tarolit II”.
9. Kjo ndërmarrje ka fituar të drejtat pronësore për lokalet e lartpërmendura afariste, në bazë të kontratës së shitblerjes, të vërtetuar në Gjykatën Komunale në Pejë, C. nr. 224/94, të 13 marsit 1994, siç është konfirmuar me Aktgjykimin e Gjykatës Komunale në Pejë, C. nr. 224/94, të 13 prill 1994.

10. Nga mesi i vitit 1999, ky lokal afarist ishte zënë nga Misioni i OSBE-së, pa marrëveshje paraprake gjegjësisht pa dijeni të pronarit të lokalit afarist.
11. Pasi ka mësuar se në lokalet e tij është vendosur Qendra Rajonale e Misionit të OSBE-së në Kosovë, z. Milorad Rajović, në vitin 1999, i është drejtuar Misionit të OSBE-së, duke kërkuar lidhjen e kontratës për shfrytëzimin e objekteve të tij dhe pagesën e qirasë përkatëse. Megjithatë, kërkesat e tij nuk janë marrë në konsideratë dhe as nuk janë pranuar.
12. Ndërmjet viteve 1999 dhe 2007, parashtruesi i dërgoi Misionit të OSBE-së një numër të madh të shkresave, duke kërkuar respektimin e të drejtave të tij pronësore dhe lidhjen e një kontrate për qiranë e objektit të lartpërmendur. Megjithatë, përveç përgjigjes me shkrim dërguar parashtruesit, Misioni i OSBE-së nuk ka ndërmarrë asnjë veprim konkret për ta zgjidhur këtë problem.
13. Më 28 dhjetor 2007, parashtruesi ushtroi ankesë në Institucionin e Avokatit të Popullit.
14. Më 3 mars 2008, Avokati i Popullit nxori Vendimin Nr. 2355/07, me të cilin e shpall të papranueshme ankesën e parashtruesit, sepse nuk ishte në përputhje me *ratione personae* në bazë të Rregullores së punës.
15. Më 15 janar 2008 u mbajt një takim ndërmjet parashtruesit të kërkesës dhe përfaqësuesit të Misionit të OSBE-së. Në atë takim, parashtruesi i kërkesës, për herë të parë, mori një ofertë konkrete nga Misioni i OSBE-së për pagesën e qirasë. Oferta, të cilën e kishte paraqitur përfaqësuesi i Misionit të OSBE-së, mbulonte vetëm periudhën pas 1 korrikut 2007, në kohëzgjatje për një vit, me mundësi të zgjatjes.
16. Parashtruesi i kërkesës pohoi se, pas disa orë negociatash, “*nën presion dhe kërcënim*” nga përfaqësuesi i Misionit të OSBE-së, ai pranoi ofertën dhe nënshkroi kontratën e qirasë, me një marrëveshje gojore që zgjidhja e borxhit të qirasë për periudhën 1999 – 1 nëntor 2007, do të vazhdonte pas nënshkrimit të kontratës së ofruar.
17. Më 20 shkurt 2008, parashtruesi i kërkesës ia dërgoi shkresën e parë përfaqësuesit të Misionit të OSBE-së, z. John Fennessy, me kërkesë për fillimin e zgjidhjes së çështjes së borxhit të mbetur për periudhën 1999 – 1 nëntor 2007.
18. Më 25 shkurt 2008, Departamenti i Administratës së Misionit të OSBE-së (John Fennessy) e informoi parashtruesin e kërkesës se kërkesa e tij për pagesën e qirasë për periudhën 1999 – 1 nëntor 2007 ishte dërguar në selinë e Misionit të OSBE-së në Vjenë, se selia e Misionit e kishte diskutuar këtë çështje dhe se është duke u pritur qëndrimi i tyre.
19. Parashtruesi i kërkesës, në periudhën prej vitit 2009 e deri më 2011, ia dërgoi tri (3) shkresa të tjera Misionit të OSBE-së.
20. Misioni i OSBE-së, në të gjitha shkresat e parashtruesit të kërkesës, dërgoi përgjigje me përmbajtje të ngjashme, “*se rasti i parashtruesit i kërkesës është me selinë e OSBE-së në Vjenë, dhe që Misioni i OSBE-së do ta informojë parashtruesin e kërkesës në lidhje me vendimin dhe qëndrimin e Qendrës, posa qëndrimi i tyre të jetë i njohur*”.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

21. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Misioni i OSBE-së qëllimisht i ishte shmangur detyrimin ndaj tij, duke qenë i vetëdijshëm për pozitën e tij, siç parashihet me Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 2000 /47.
22. Në mbështetje të pretendimit të tij, parashtruesi i kërkesës citon rastin e Bankës Kreditore të Prishtinës kundër Misionit OSBE-së, në vitin 2011, ku Gjykata Komunale në Prishtinë, me aktvendimin EDA. nr. 2553/2011, të 30 dhjetorit 2011, lejoi ekzekutimin kundër Misionit të OSBE-së për qiranë e papaguar për shfrytëzimin e lokaleve afariste të Bankës.
23. Më 30 prill 2012, Misioni i OSBE-së, me parashtrësën HOM/54/12, e kontestoi këtë ekzekutim, duke u thirrur në imunitetin e tij të paraparë me dispozitat e Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 2000/47.
24. Në bazë të parashtrësës së Misionit të OSBE-së, HOM/54/12, Gjykata Komunale në Prishtinë pastaj e anuloi Aktvendimin EDA. nr. 2553/2011.
25. Gjykata Komunale theksoi se një kreditor mund të zgjidhë këtë çështje duke iu drejtuar Komisionit për kërkesa, i cili ishte themeluar nga KFOR-i dhe UNMIK-u, në pajtim me nenin 7 të Rregullores UNMIK/RREG 2000/47, të 18 gushtit 2000.
26. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, me shkresën e 10 shtatorit 2009, ai i ishte drejtuar "Panelit Këshillimor për të Drejtat e Njeriut", përkatësisht Komisionit të kërkesave, dhe se nga ky Këshill ka pranuar vetëm një shkresë, e cila është regjistruar me Nr. 308/09, me të cilën ata e informojnë se kërkesa e tij është pranuar dhe se është caktuar personi që do të marrë rastin.
27. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, pretendon "*që për disa vite nuk kishte marrë asnjë shkresë nga Paneli Këshillimor për të Drejtat e Njeriut*".
28. Parashtruesi i kërkesës, në kërkesën e tij, pretendon se iu ka mohuar e drejta për mjet juridik për t'i mbrojtur të drejtat e tij pronësore. Bazë për pretendimin e parashtruesit është Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 2000/47, si dhe Ligji 2008/03-033. Neni 2.1 i këtij Ligji parasheh: "UNMIK-u (në këtë rast OSBE-ja), prona e tij, fondet dhe asetet, janë të përjashtuara nga çdo proces ligjor".
29. Parashtruesi i kërkesës iu drejtua Gjykatës Kushtetuese me kërkesat e mëposhtme:

"Që kjo Gjykatë të hapë dhe zhvillojë procedurën përkatëse gjyqësore në pajtim me dispozitat e nenit 46 të Ligjit nr. 03/L-121 "Për Gjykatën Kushtetuese të Republikës Kosovës" dhe gjatë zhvillimit të kësaj procedure të benë vlerësimin juridik të fakteve dhe argumenteve të prezantuara, të benë ekzaminimin e provave dhe që, në bazë dispozitave Kushtetuese dhe dispozitave përkatëse ligjore vendore e ndërkombëtare, të benë vlerësimin e ligjshmërisë dhe kushtetutshmërisë se dispozitave të larte përmendura të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2000/47 "Mbi statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe personelit të tyre" dhe të Ligjit nr. Nga aspekti i mbrojtjes se të drejtave dhe lirive themelore dhe të pacenueshme të qytetarëve të Kosovës dhe pastaj, në bazë të dispozitave përkatëse Kushtetuese, akteve juridike vendore e ndërkombëtare veçanërisht të theksuara me nenin 22/31 e lidhur me nenin 46 të kësaj Kushtetute, nenit 6.1 të Konventës Evropiane për të drejtat dhe liritë themelore të njeriut".

“Të shpallë të gabuara, të pabazuara, jo të drejta, kundër-kushtetuese dhe të kundërligjshme interpretimet e dispozitave mbi imunitetin e përcaktuara me Rregulloren se UNMIK-ut nr. 2000/47 "Mbi statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe personelit të tyre dhe me Ligjin nr 2008/03-Lo33 për statusin, imunitetin dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin në Kosovë dhe pranin ndërkombëtare ushtarake si dhe personelin e saj"; për rastet e cenimit dhe shkeljes së të drejtave pronësore të qytetareve të Kosovës si të drejta dhe liri të pacenueshme, të patjetërsueshme e themelore të njeriut përkatësisht qytetareve në Kosovë dhe për rastet e kërkesave materiale - financiare të qytetareve të Kosovës, borxheve e dëmshpërblimeve civile lidhur me shfrytëzimin e shërbimeve dhe pronës private të qytetareve të Kosovës apo të dëmtimeve të tyre”.

“Të cakton si kompetente Gjykatën Ekonomike në Prishtinë apo Gjykatën Supreme të Kosovës - Dhoma e Veçantë në Prishtinë që të vendosë lidhur me kërkesat e Ndërmarrjes Private "UDARNIK KOMERC" në emër të qirasë së papaguar për shfrytëzimin e lokaleve të saj afariste nga ana e Misionit të OSBE-se - Qendra Regjionale Pejë në periudhën Korrik 1999 - 01.11.2007”.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

30. Për të gjykuar kërkesën e parashtruesit, Gjykata duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të parapara me Kushtetutë, me Ligj dhe me Rregullore të punës.
31. Përkitazi me këtë, Gjykata i referohet nenit 113, paragrafi 1 dhe paragrafi 7, të Kushtetutës.

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar”.

“7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

32. Në këtë rast, parashtruesi kërkon “vlerësimin e kushtetutshmërisë së Rregullores së UNMIK-ut, Nr. 2000/47, për statusin, privilegjet dhe imunitetin e KFOR-it, UNMIK-ut dhe personelit të tij në Kosovë, si dhe të Ligjit 2008/03-033 të Republikës së Kosovës për statusin, imunitetin dhe privilegjet e misioneve diplomatike, konsullore dhe personelin në Kosovë dhe praninë ndërkombëtare ushtarake si dhe personelin e saj”, dhe, në këtë mënyrë, Kushtetuta në mënyrë shumë të qartë e përcakton në nenin 113 se kush mund të kërkojë vlerësimin e kushtetutshmërisë së ligjit.
33. Një kërkesë e tillë për “vlerësimin e kushtetutshmërisë së Rregullores së UNMIK-ut Nr. 2000/47 dhe Ligjit 2008/03-033”, është kontestim abstrakt i Rregullores dhe Ligjit të lartpërmendur. Në qoftë se ky është qëllimi i parashtruesit të kërkesës si individ, atëherë ai nuk mund të konsiderohet si palë e autorizuar.
34. Neni 113.2, neni 113.6 dhe neni 113.8 të Kushtetutës shprehimisht parashohin se cilat janë palë të autorizuar që mund t’i drejtohen Gjykatës për çështjen e vlerësimit abstrakt të kushtetutshmërisë të ligjit.
35. Gjykata vëren se, në këtë rast, parashtruesit të kërkesës i mungon “pozicioni” ose autoriteti në Gjykatë, sepse parashtruesi i kërkesës nuk i ka plotësuar kërkesat e nenit

113.1 të Kushtetutës. Përveç kësaj, sistemi kushtetues juridik i Kosovës nuk parasheh *actio popularis*, që është modalitet i kërkesave individuale që ia siguron çdo individ, i cili dëshiron të mbrojë interesin publik dhe rendin kushtetues, mundësinë për t'iu drejtuar Gjykatës Kushtetuese përkitazi me atë shkelje, edhe pse ai/ajo nuk e ka statusin e viktimës.

36. Prandaj, Gjykata konsideron se parashtuesi i kërkesës nuk është palë e autorizuar për të kërkuar interpretimin e Rregullores së UNMIK -ut Nr. 2000/47 dhe të Ligjit 2008/03-033. Dhe, kjo kërkesë duhet të shpallet e papranueshme, sepse është parashtuar nga pala e paautorizuar.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.1 dhe me nenin 113.7 të Kushtetutës; në pajtim me nenin 46, me nenin 47 dhe me nenin 48 të Ligjit; si dhe me rregullin 36.1.a dhe 36.3.c të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 25 janar 2013, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të botohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- III. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues


Robert Carolan



Kryetari i Gjykatës Kushtetuese


Prof. dr. Enver Hasani